

NJOFTIM PËR VEND VAKANT PËR SPECIALIST I.T.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, kërkon të punësojë një punonjës në administratë me detyrë specialist IT që do të mbulojë nevojat e institucionit që lidhen me internetin, kompjuterat, rrjetin kompjuterik dhe sistemin CAMS.

Kushtet e përgjithshme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë nën hetim;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- e) të ketë përfunduar arsimin e lartë në fushat e përcaktuara në rubrikën “Kushtet e posaçme”.

Kushtet e posaçme:

- a) Të ketë eksperiencë pune
- b) Njohuritë e sistemeve kompjuterike dhe pajisjeve hardëare.
- c) Njohuritë në lidhje me sistemet e operimit dhe funksionimin e rrjeteve (LAN dhe WAN)
- d) Njohuritë mbi operimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve web based.
- e) Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja.
- f) Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
- a) Të ketë përfunduar arsimin e lartë 5 vjeçar ose 3+2, në fushat: inxhinieri informatike, shkenca kompjuterike, inxhinieri elektronike, Teknologji Informacioni, apo degë të tjera të ngjashme.

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, deri në datën e përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhëri, këto dokumenta:

- a) Kërkesë për punësim,
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së lartë, certifikatë notash dhe çdo diplomë tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar.
- e) Dëshmi penaliteti.
- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht .

- g) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- h) Vërtetim vendbanimi.
- i) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, **deri në datën 06.05.2019 ora 16.00 duke konfirmuar marrjen në dorëzim sipas inventarit të akteve të dorëzuara.**

Verifikimi paraprak i kandidatëve do të bëhet nga Kancelarja e kësaj Prokurorie, e cila pasi të marrë praktikat dokumentare për secilin kandidat duhet të verifikojë nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe veçanta.

Vlerësimi i kandidatëve dhe perzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nga Komisioni i Pranimi bazuar në dokumentacionin e secilit kandidat si dhe rezultatit të intervistës me secilin prej tyre, bazuar në Urdherin nr. 28 prot date 15.04.2019 “*Per ngritjen e komisionit per vleresimin e kandidaturave per plotesimin e vendit vakant per Specialist IT ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Elbasan*”. Intervista me secilin kandidat, do të kryhet në ambjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, **në datë 08.05.2019, nga ora 12.00 deri në orën 14.00.** Njoftimi i datës së intervistimit për kandidatët e kualifikuar do të bëhet me telefon ose email nga Kryesekretaria.

Per çdo sqarim mund të kontaktoni në numrin 054242674, ose vizitoni faqen e internetit www.pp.gov.al.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.